



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8913 Prot.

Roskovec, më 03, 10 2022

VENDIM

NR. 67 .DATË 30 . 09 .2022

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN GUSHT 2022”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.08.2022, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Gusht 2022.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 1191 Prot.

Roskovec, më 30.08.2022

Procesverbal Nr.9

-I mbajtur sot, date 29.08.2022, ora 11⁰⁰, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Korrik 2022.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Korrik 2022.
5. Për caktimin e përfaqësuesit ligjor për përfaqësimin e Këshillit Bashkiak Roskovec në çështjen gjyqësore përkatëse.
6. Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Roskovec në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
7. Ngritjen e grupeve vullnetare për aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive.
8. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.
9. Për miratim fondi për ndihmë për familjen e Zamira Sakaj.
10. Për miratimin e projektit “Hartimi i projektit-preventiv, zbatimit për objektin “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut Nr.3 në qendër të qytetit Roskovec (faza 1)”.
11. Dhënien në përdorim të një ambienti zyre.
12. Informacion për projektin e fituar nga BE për bashkitë “Rivitalizimi i Shkollës Qendër Komunitare në Kurjan, për një akses më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e pafavorizuara”.
13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11⁰⁰

Keshilltaret prezent: V. Mata, L. Hoxha, L. Goga, B. Çobo, T. Kuka, K. Hyska, G. Hoxha, A. Hazizi, V. Bakaj, V. Dogani, A. Sheme, H. Beqiraj, B. Toska, M. Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : A. Kola, E. Cepele, Rr. Hazizi, B. Kuka, D. Hoxha.

Prezent nga bashkia: Nenkryetaret M. Goga, K. Lushka, Dr. Finances, Dr. Urbanistikes, Sp/Juriste, Sek. e Pergjithshme, SP/Z/Sherbimit Social, Sp/Emergjencave Civile. Prezent edhe 3 qytetare.

Me plotesimin e kuorumit ,kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 14 keshilltare.Kryetari i falenderon keshilltaret per pjesemarrjen.Ben me dije se kjo mbledhje do te transmetohet live ne fcb e keshillit per nje vendimmarrje sa me transparente per qytetaret.Fillon me rendin e dites.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

2.Information mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Korrik 2022.

Sekretarja e keshillit sqaron informacionin i cili ka te bej me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar.2 vendime ishin akte normative te cilat i derguam ne Prefektura.Keto vendime jane konfirmuar nga Prefektura ne perputhje me ligjin.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Korrik 2022.

P/Z/Ndhimes Ekonomike Sidorela sqaron projektin.Ve ne dukje ndryshimet kete muaj,kemi shtuar vetem familjen e Zamira Sakaj,te ciles i ndodhi fatkeqesia qe ju te gjithe e dini.Nuk ka diskutime. Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

5. Për caktimin e përfaqësuesit ligjor për përfaqësimin e Këshillit Bashkiak Roskovec në çështjen gjyqësore përkatëse.

Sp/e zyres juridike sqaron projektin.Propozojme qe ju si keshill ne ceshtjen qe keni per gjykim te perfaqesoheni ng bashkia Roskovec,personi i autorizuar nga kryetarja per kete ceshtje.Leksi-ky gjyq ka te bej me tarifen e ndotjes se mjedisit ne Marinez?Juristja-po,eshte duke vazhduar gjyqi,prandaj duhet caktimi i nje perfaqesuesi nga keshilli.Hidhet ne votim projekti sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

6.Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Roskovec në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimit,largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Sp.Juristja sqaron marrevshjen per pjesmarrjen e bashkise ne subjekte me kompetenca te perbashketa.Leksi-ne mbledhjen e qershorit e kaluam njehere,pse duhet ta kalojme prape kete?Zare Shabanaj sqaron se ju keni miratuar autorizimit e kryetares per lidhjen e marreveshjes,tani po miratoni marreveshjen sipas hapave ligjor te percaktuar ne VKM.Delina-pas miratimit nga ju te kesaj marreveshje,subjekti i krijuar do e dergoje marreveshjen ne prefektura per shprehje ligjshmerie.Nuk ka me pyetje.Hidhet ne votim miratimi i marreveshjes dhe pjesmarrjen e bashkise Roskovec ne subjekte me kompetenca te perbashketa sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

7.Per ngritjen e grupeve vullnetare për aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit e të përballimit të fatkeqësive.

Nenkryetari M.Goga sqaron se kjo eshte nje risi.Ne kemi mbeshtetjen ligjore per krijimin e tyre.Sp.Emergjencave Civile sqaron projektin.Bujari-mbi ca bazash i keni percaktuar keta aktiviste?Maksi-ne baze te bisedave me kryetaret e fshatrave,kemi biseduar.Bujari-kane aftesi profesionale per kete pune?

Maksi-jemi konsultuar me kryetaret e fshatrave si dhe eksperienca e disa viteve,te cilet jane marr me pune te tilla.Gjate rruges mund te kete dhe skualifikime.Bujari-a eshte diskutuar me keta persona dhe kane rene dakort?Maksi-kane rene dakort.Vjollca-Mbersi nuk ka kryetar fshati,me ke

u konultove per ato fshatra qe nuk kane kryetar?Maksi-per ato jemi konsultuar me administratoret e njesive perkatese.Vjollca-sa te gatshem jane keta persona,se ata mund te jene dhe te larguar kur bie zjarri?Maksi-ata jane vullnetare,por nese nuk do te jene te zotet do te zevendesohen gjate rruges.Por keta persona jane me te specializuar.Bujari-ne rast se nje nga keta do digjet,qe mos o zot si do veprohet?Maksi-do trajnohen personat.Viktori-pse nuk jane perfshire te gjithë fshatrat?Maksi-jane perfshire vetem ato fshatra ku ka rrezik per zjarr dhe permbytje.Ne Marinez jane zjarrfikeset e Bankersit.Hidhet ne votim projekti i ngritjes se grupeve vullnetare per aktivite te mbrojtjes civile sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

8.Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2022.Kryetari ben me dije se per arsye se disa pika te ketij projekti jane normative dhe disa jo,ne kete projekt e kemi ndare ne 2 projekte me tituj : “Per perdorimin e fondit te kushtezuar te emergjencave civile per vitin 2022” dhe “Per miratim rishperndarje fondesh nga fondi rezerve ne Buxhetin e Bashkise Roskovec per vitin 2022”.

Dr.Finances sqaron se ky projekt-vendim do ndahet ne 2 projekt-vendime me tituj si me siper,per arsye se disa pika te projektit nuk jane akte me karakter normative,dhe disa pika te projektit jane me karakter normative,prandaj per kete arsye kemi bere ndarjen e projektvendimit qe ju kemi derguar ne dy projektvendime te ndara me vete,dhe do zbardhen dy vendime me vete.Dr.Finances Selmani sqaron projektet dhe zerat perkates me detaje.Maksi-sqaron ne lidhje me fondin e kaldajave dhe mirembajtjes se tyre.Sqaron fondin per riparimin e pompave per vaditje.Maksi sqaron dhe fondin e emergjencave civile.Ky fond do hidhet vetem per emergjencat civile,nuk e perdorim dot per gjera te tjera.Vjollca-per shkollat jane ngritur grupe pune per kontrollin e tyre te gjendjes fizike?Shkolla ne Vlosh brenda eshte komplet copa,prizat jane cope-cope,ju rregulloni kaldaja kur shkolla fillon pasneser?Maksi-para fillimit te shkolles do merren te gjitha masat,i kemi dhene porosi drejtorit te ndermarrjes per te bere riparimet qe duhen.Para se te filloje shkolla ato do jene te riparuar,do e marim si detyre.Kadriu-shkolla e Vloshit eshte marr ne dorezim nga 1 punetor dhe ai punetor ka punuar vetem 1 ore dhe ka nisur fotot.Ne shkollen e Vloshit banjot nuk funksionojne,telat jane neper kembe,duhet te lyhet shkolla te mbushen gropat.Leksi-ndoshta atje eshte punuar,por problem eshte cilesia e punimeve ne investime dhe punime,prandaj dhe Vjollca e ngre me te drejte kete problem.Leksi-investimet duhet te jene me cilesi,ne i kemi kaluar fondet per komunitetin,por ama te jene punime me cilesi sepse le shume per te deshruar,dhe te kete kontrolle rigoroze.Maksi-ankesen e Vjollces do e marr une persiper si detyre ne menyre emergjente.Dr.Finances sqaron projektvendimin e perdorimit te fondit te emergjencave civile.Sqaron sipas zerave perkates fondin per tarifen e primit te sigurimit te jetes se vullnetareve,shpenzime per ushqime per vullnetaret qe do angazhohen ne aktivite te mbrojtjes civile,shpenzime per veshje dhe pajisje te ndryshme per vullnetaret,fondin per nderhyrje emergjente ne infrastrukture per mbrojtje nga fatkeqesite natyrore sipas zerave perkates ne projekt.Hidhet ne votim projekt-vendimi per perdorimin e fondit te kushtezuar te emergjencave civile per vitin 2022 sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.Selmani sqaron zerat e projektvendimit tjeter,fondi per riparim dhe mirembajtje te pompave te vaditjes,riparim dhe mirembajtje te kaldajave te shkollave,sigurimin e instrumenteve fillestar te GVV-se.Hidhet ne votim projektvendimi per shperndarje fondesh nga fondi rezerve ne buxhetin e vitit 2022 sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

9.Per miratim fondi per ndihme per familjen e Zamira Sakaj.

Maksi-para disa javesh ne kete familje humbi jeten djali i cili u mbyt ne lum.Ne vajtem pame gjendjen e familjes dhe pame nje gjendje shume te veshtire ekonomike,dhe morem kete hap per ti ardhur sado pak ne ndihme,duke marr persiper shpenzimet e varrimit dhe futjen e familjes ne skemen e 6%.Vjollca-ne jemi dakort dhe i shprehim ngushellime familjes.Leksi-jam shume dakort dhe i shprehim ngushellime familjes,por pse duhet te kujtohem i pasi ndodh fatkeqesia?Lumturia-une e njoh familjen,ata me para kane marr ndihme ekonomike,por ua hoqen.Maksi sqaron historikun e kesaj familje,dhe hapat e pare qe ne si bashki morem me 2 projekte te propozuara sot dhe qe ju po i miratoni sot.Keshilltaret jane dakort dhe i shprehin ngushellime familjes Sakaj per humbjen e djalit te mitur.Hidhet ne votim projektvendimi miratim fondi per ndihme per familjen e Zamira Sakaj dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

10. Për miratimin e projektit “Hartimi i projektit-preventivit,zbatimit për objektin “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut Nr.3 në qendër të qytetit Roskovec (faza 1)”.

Aleksander-pyet per token e fushes se sportit,ca u be me token?Maksi jep sqarime.Dr.Urbanistikes Eneida Hoxha sqaron projektin.Ky projekt per rehabilitimin urban i nje pjese te Bllokut Nr.3 po prezantohet me video projektor.Eshte hartuar projekti sipas kriterëve ligjore.Pjese e projektit eshte fusha e sportit,parku,sistemimi i kanalit kullues,Posta e Policise.Perfaqesuesi i zyres se projektimit sqaron projektin dhe pjeset e projektit me detaje me video projektor.Tek pjesa e rrugeve do te kemi disiplinim te tubove,do jene me ndricim gjelberim.Sqaron tribunën e stadiumit dhe ambientet e stadiumit,duke iu referuar standarteve bashkekohore si Fifa.Do te kete rreth 20 dyqane qe do te jene pjese e struktures se stadiumit.Kapaciteti i stadiumit eshte mbi 1000 vende.Sqaron parkun,do te kete stola shlodhes dhe per aktivite,do te kete nje shatervan,eshte bere dhe studimi hidraulik per shatervanin.Jane parashikuar dhe kende lojrash.Do te kete sistemim te perroit,do te kete rruge automobilistike dhe rruge pedonale.Posta e re e Policise sqaron siperfaqen e Postes,godina do te kete te gjitha ambientet e pershtatshme,sqaron hapsiren e gjelberuar rreth Postes.Eneida sqaron afatin kohor dhe vleren ne leke per secilin nenobjekt.Leksi-ne ketu po kalojme projektin e nje pjese te Bllokut Nr.3,eshte nje vlere shume e madhe,tek kjo shifer eshte futur dhe shpronosimi?E keni llogaritur pjesen e shpronosimeve,sa mund te vej vlere e shpronosimeve?Maksi-falenderon per punen e pregatitur nga te gjithë komponentet per kete projekt.Maksi-nuk eshte momenti per te diskutuar per shpronosimet,ne sot po kalojme hapin e pare qe eshte miratimi i projektit.Eneida-ne kete projekt kemi 4 nenobjekte,por keto mund te ndertohen dhe vec e vec ne baze te mundesive financiare qe do gjejme.Vjollca-do te kete vend parkimi ne projekt per stadiumin?Bujari-falenderime per studion,mos na mbetet pezull stadiumi,sepse shpronosimet mund te jene me fond me te larte,nga do i gjejme ne keto fonde per shpronosime?Maksi-ka nje ligj te shpronosimeve,jo te gjitha kalojne me fonde te bashkise.Eneida-persa i perket parkimit fusha eshte parashikuar me standarte europiane,patjeter qe parkimin do e zgjidhim.Leksi-ambicja e Kryetares eshte qe te behet fusha,jemi dakort me projektin.Eneida sqaron se projekti zhvillimor i ketij blloku do te kushtezojë gjithë zhvillimin e aktivitetit urban,permiresime te gjendjes se rrugeve,te infrastruktures mbitokesore dhe nentokesore,te prishjes se objekteve ekzistuese,shpronosime dhe ndertime te reja,ndertimit te ambienteve shlodhese per cdo grup moshe.Rikualifikimi i nje pjese te Bllokut Nr.3 do ti jap nje pamje te re qytetit.Stadium me standarte te Fifa-s,hapsira te gjelberta,rruge me standarte europiane dhe godina e re e Postes se Policise.Hidhet ne votim projektvendimi sipas materjalit dhe prezantimit te ber sot dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

11.Dhenien ne perdorim te nje ambienti zyre.

Sp.juriste Zare Shabanaj sqaron projektin.Sqaron ambientin qe do te jepet ne perdorim,e cila do te sherbeje si seli e organizates qe do krijohet nga GVV-ja.Maksi-ka te bej me thithjen e fondeve nga BE ne lidhje me sqarimin e GVV-se.Aleksander-po nese vitin tjetër nuk pranojne te rrine aty?Ambienti qe do te jepet si zyre per seline e GVV-se ndodhet ne objektin 3 katesh social per strehim,kati perdhe,apartamenti nr.2 me siperfaqe 43m2.Hidhet ne votim projektvendimmi i dhenies ne perdorim te nje ambienti zyre sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

12. Informacion për projektin e fituar nga BE për bashkitë “Rivitalizimi i Shkollës Qendër Komunitare në Kurjan,për një akses më të mirë në zhvillimin social dhe ekonomik për të rinjtë dhe grupet e pafavorizuara”.

Dr.Urbanistikes E.Hoxha sqaron projektin e fituar nga Bashkimi European per rivitalizimin e shkollës Qender Komunitare Kurjan,per nje akses me te mire ne zhvillimin social dhe ekonomik per te rinjte dhe grupet e pafavorizuara.Eneida sqaron projektin dhe objektivat kryesore : rritja e mundesise se punesimit per te rinjte dhe forcimi i kapaciteteve te bashkise Roskovec,trajnimi i stafit te bashkise.Projekti zbatohet per 34 muaj,do filloj ne Tetor si projekt.Maksi-jane marr masat per transferimin e nxenesve te shkollës se e gjithë shkolla do ristaurohet.Projekti do funksionojë si qender komunitare 34 muaj.Do trajnohen te rinjte e zones.Ky projekt do ti ofroje te rinjve dhe grupeve te pafavorizuara trajnime profesionale me qellimin kryesor shkeputjen nga kultivimi i lendeve narkotike,ofrimit te nje profesioni me qellim punesimin.Restaurimi i shkollës Qender Komunitare Kurjan do te realizohet per te arritur keto qellime,per te ofruar trajnime ne ambiente bashkekohore.Ky projekt fitues nga bashkia po u prezantohet keshilltareve me video projektor.Maksi ve ne dukje kontributin qe ka Ministria e Rinise dhe Sportit per kete projekt.

13.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Durim Bakaj-ne lidhje me riparimin e shtepive te miratuara.Eneida jep sqarime.Durimi-problem me parkimin ditën e Diel,territori i bashkise pse mos ti lihet qytetareve per parkim ditën e Diel,qofte edhe kundrejt nje pagese?Aleksander-Nga bukuroshja deri tek gjimnazi te kufizohet levizja e makinave cdo te Diel sepse eshte bere burim aksidenti.Leksi-problemi i qenve rrugac qe jane shtuar shume,problem qent edhe tek varrezat,nuk lene me gje atje pa prishur,gjerat qe cojne njerzit ne varreza.Para disa ditësh qent kishin ven poshte nje djale.Qente rrugac ne rruge jane bere vertet nje problem serioz per qytetaret.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Kadri Hyska